



Akti i të Drejtave të Prindit

për Nxënësit e Anglishtes/Nxënësit Shumëgjuhësh

Draft

DEPARTAMENTI I SHTETIT TË CONNECTICUT PËR EDUKIMIN

Bazuar në [P.A.23-150 Paragrafi 17](#), Bordi i Shtetit për Edukimin duhet të hartojë një akt të shkruar të të drejtave të prindërve ose kujdestarëve të nxënësve shumëgjuhësh, për të garantuar që të drejtat e këtyre prindërve dhe nxënësve janë të ruajtura dhe të mbrojtura në masë të mjaftueshme në ofrimin e edukimit dygjuhësh, sipas Kapitullit 164 të statutit të përgjithshëm dhe në përhapjen e këtij Akti të të Drejtave në gjuhën mbizotëruese të prindërve ose kujdestarëve.

Kjo do të thotë se sipas P.A.23-150 Paragrafi 17, Bordi i Shtetit për Edukimin do të hartojë një listë të qartë të të drejtave të prindërve ose kujdestarëve të nxënësve të cilët janë duke mësuar disa gjuhë. Kjo listë do të sigurojë që të drejtat e këtyre prindërve dhe nxënësve ruhen dhe mbrohen ndërsa ata marrin edukimin dygjuhësh sipas përshkrimit në Kapitullin 164 të Statutit të Përgjithshëm të Connecticut-it (C.G.S.). Lista e të drejtave do t'u jepet prindërve ose kujdestarëve në gjuhën që ata kuptojnë më mirë.

Për vitin akademik që nis më 1 korrik 2024 dhe çdo vit akademik pasues, çdo bord i edukimit lokal ose rajonal që ofron një program të edukimit dygjuhësh ose programin 'anglishtja si një gjuhë e re', do të:

1. Ofrojë prindërve ose kujdestarëve të nxënësve që plotësojnë kushtet, një kopje të aktit të të drejtave të nxënësve shumëgjuhësh në gjuhën mbizotëruese të atij prindi ose kujdestari; dhe
2. Ofrojë këto kopje të të drejtave të nxënësve shumëgjuhësh në faqen e internetit të atij bordi.

Kjo do të thotë se duke nisur nga 1 korrik 2024 dhe në vitet në vijim, çdo bord lokal ose rajonal i edukimit që ofron edukim dygjuhësh ose programin 'anglishtja si gjuhë e re' duhet:

1. T'u japë prindërve ose kujdestarëve të nxënësve që plotësojnë kushtet një kopje të aktit të të drejtave të nxënësve shumëgjuhësh në gjuhën që ata kuptojnë më mirë.
2. Ta ofrojnë këtë akt të të drejtave të nxënësve shumëgjuhësh në faqen e internetit të bordit.

Këto janë deklaratimet e Aktit të të Drejtave të Nxënësve të Anglishtes/Nxënësve Shumëgjuhësh

1. E drejta e një nxënësi të anglishtes / nxënësi shumëgjuhësh për të qenë pjesë e një shkolle publike në shtet pavarësisht statusit të emigracionit të këtij nxënësi ose statusit të emigracionit të prindërit ose kujdestarit të këtij nxënësi.

Kjo do të thotë se një nxënësi i anglishtes ose dikush që flet disa gjuhë ka të drejtë të shkojë në një shkollë publike të shtetit edhe pse ai nxënësi ose prindërit/kujdestarët e tij janë emigrantë.

2. E drejta e një prindi ose një kujdestari të një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të regjistruar një nxënësi të tillë në një shkollë publike pa u kërkuar paraqitja e dokumenteve të emigracionit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, një numër të Sigurimeve Shoqërore, dokumentacioni i vizave ose vërtetim i shtetësisë.

Kjo do të thotë se një prind ose kujdestar i një nxënësi i cili po mëson anglisht ose flet disa gjuhë, mund të regjistrojë fëmijën e tyre në një shkollë publike pa pasur nevojën për të paraqitur ndonjë dokumentacion emigracioni si një numër të Sigurimeve Shoqërore, dokumente të vizës apo vërtetim i të qenit nënshtrë.

3. E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të pasur shërbime përkthimi të ofruara nga (A) një përkthyes i cili është i pranishëm personalisht ose i gatshëm me anë të telefonit ose nëpërmjet një platforme të teknologjisë online, ose (B) nëpërmjet një faqeje interneti ose aplikacion tjetër elektronik i aprovuar nga Bordi i Shtetit për Edukimin, gjatë ndërveprimeve kritike me mësuesit dhe administratorët, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, mbledhjet prindër - mësues, takime me administratorët e shkollave në të cilat nxënësi është pjesë dhe në takimet me njoftim të rregullt ose takime të veçanta të bordit të edukimit ose takime të rezervuara me një anëtar ose anëtarë të bordit të edukimit - përgjegjës për edukimin e këtij nxënësi, sipas Paragrafit 18 të këtij Akti.

Kjo do të thotë se një nxënësi i anglishtes/shumëgjuhësh ka të drejtën të marrë ndihmë me përkthim gjatë takimeve të rëndësishme që përfshijnë edukimin e nxënësit. Kjo ndihmë mund të vijë nga një përkthyes i pranishëm, në telefon ose nëpërmjet kompjuterit. Ka të bëjë me biseda të rëndësishme me mësuesit dhe udhëheqësit e shkollës, siç janë takimet prindër - mësues apo takimet me administratorët e shkollës. Kjo është në përputhje me një paragraf specifik të ligjit, i quajtur paragrafi 18 i këtij Akti.

- 4.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të marrë pjesë në një program të edukimit dygjuhësh të ofruar nga bordi lokal ose rajonal i edukimit ku ka njëzet ose më shumë nxënës që plotësojnë kushtet të klasifikuara si mbizotëruese në një gjuhë tjetër përveç anglishtes, në përputhje me parashikimet e Paragrafit 10-17f të C.G.S.-së.

Kjo do të thotë se një nxënës i anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh ka të drejtën t'i bashkohet një programi edukimi dygjuhësh nëse një i tillë kërkohet në shkollë. Kjo bazohet në rregullat e Paragrafit 10-17f të C.G.S.-së.
- 5.** E drejta e një prindi ose kujdestari të një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të marrë njoftim me shkrim, si në anglisht ashtu dhe në gjuhën mbizotëruese të prindit ose kujdestarit, nëse një nxënës i tillë plotëson kushtet për të marrë pjesë në një program edukimi dygjuhësh ose programin 'anglishtja si gjuhë e re', të ofruar nga bordi lokal ose rajonal i edukimit.

Kjo do të thotë se një prind ose kujdestar i një nxënësi i cili po mëson anglisht ose flet disa gjuhë ka të drejtën të marrë një njoftim me shkrim si në anglisht ashtu dhe në gjuhën që ata njohin më mirë për t'i njoftuar ata se fëmija e tyre mund t'i bashkohet një programi edukimi dygjuhësh ose programit anglishtja si gjuhë e re, e ofruar nga qarku.
- 6.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh dhe prindit ose kujdestarit të një nxënësi të tillë për të marrë një seancë orientimi të kualitetit të lartë në gjuhën mbizotëruese të një nxënësi të tillë dhe prindit ose kujdestarit, nga një bord lokal ose rajonal i edukimit që ofron informacion në lidhje me standardet e shteteve, testet dhe pritshmëritë në shkollë për nxënësit e anglishtes/nxënësit shumëgjuhësh, si dhe qëllimet dhe kërkesat për programet e edukimit dygjuhësh dhe programit 'anglishtja si gjuhë e re', përpara pjesëmarrjes në një program të tillë të edukimit dygjuhësh ose programit 'anglishtja si gjuhë e re'.

Kjo do të thotë se nxënësit e anglishtes dhe prindërit ose kujdestarët e tyre kanë të drejtën të marrin pjesë në një takim të dobishëm në gjuhën që zotërojnë më mirë. Ky takim do të organizohet nga bordi i shkollës lokale dhe do t'u japë atyre informacione mbi standardet shtetërore, testet dhe pritshmëritë në shkollë të nxënësve të anglishtes ose nxënësve që flasin disa gjuhë. Ata gjithashtu do të mësojnë rreth qëllimeve dhe rregullave për programet e edukimit dygjuhësh dhe programit 'anglishtja si gjuhë e re', para se t'i bashkohen këtyre programeve.
- 7.** E drejta e prindit ose kujdestarit të një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të marrë informacione rreth progresit e një nxënësi të tillë në zhvillimin dhe përthithjen e gjuhës angleze.

Kjo do të thotë se një prind ose një kujdestar i një nxënësi që po mëson anglisht ose flet disa gjuhë ka të drejtën të marrë përditësime dhe informacione se sa mirë po shkon fëmija i tyre në përmirësimin e aftësive gjuhësore të anglishtes.
- 8.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh dhe e prindit ose kujdestarit të një nxënësi të tillë për t'u takuar me personelin e shkollës për të diskutuar zhvillimin dhe përthithjen e gjuhës angleze nga ky nxënës.

Kjo do të thotë se nxënësit që po mësojnë anglisht ose flasin disa gjuhë dhe prindërit ose kujdestarët e tyre kanë të drejtën të takohen me stafin e shkollës për të folur se sa mirë nxënësi po mëson anglisht dhe po zhvillon aftësitë gjuhësore të tij.
- 9.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për t'u vendosur në një program të edukimit dygjuhësh ose programin 'anglishtja si gjuhë e re', nëse ofrohet nga bordi lokal ose rajonal i edukimit.

Kjo do të thotë se nxënësi i anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh ka të drejtë t'i bashkohet një programi të edukimit dygjuhësh ose programit 'anglishtja si gjuhë e re' nëse bordi i shkollës lokale e ofron atë.
- 10.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të pasur qasje të barabartë në programimin e të gjitha niveleve të notave të shkollës.

Kjo do të thotë se një nxënës i anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh ka të drejtë për të pasur të njëjtat mundësi në marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet e shkollës për nivelin e klasës së tij.
- 11.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të pasur qasje të barabartë në të gjitha çështjet thelbësore të niveleve të notave.

Kjo do të thotë që një nxënës i anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh ka të drejtën të mësojë të gjitha lëndët e rëndësishme për nivelin e klasës së tyre, ashtu sikurse studentët e tjerë.
- 12.** E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të kryer testim vjetor të njohurive gjuhësore.

Kjo do të thotë se një nxënës i anglishtes ose dikush që flet disa gjuhë ka të drejtë të kryejë një testim gjuhësor çdo vit për të shikuar se sa mirë janë ata në aftësitë e tyre gjuhësore.

3 Akti i të Drejtave të Prindit për Nxënësit e Anglishtes/Nxënësit Shumëgjuhësh

13. E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të marrë shërbime mbështetëse të përafuara me çdo plan ndërhyrjeje që shkolla ose drejtoria arsimore rajonale ofron për të gjithë studentët.

Kjo do të thotë që një nxënës i anglishtes/nxënës shumëgjuhësh ka të drejtën të marrë ndihmë shtesë (nëpërmjet ndërhyrjes) që përkon me planin që përdoret nga shkolla ose drejtoria arsimore rajonale për të ndihmuar të gjithë nxënësit.

14. E drejta e një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh të jetë vazhdimisht dhe në çdo vit i regjistruar në një program edukimi dygjuhësor ose programin 'anglishtja si gjuhë e re', ndërsa ky nxënës qëndron si nxënës që i plotëson kushtet, sipas përcaktimit të paragrafit 10-17e të statutit të përgjithshëm.

Kjo do të thotë se një nxënës i anglishtes ose dikush që flet disa gjuhë mund të qëndrojë në një program edukimi dygjuhësor ose në programin 'anglishtja si gjuhë e re', çdo vit, për sa kohë që ata akoma i plotësojnë kushtet, sipas shpjegimit të Paragrafit 10-17e të C.G.S.-së.

15. E drejta e një prindi ose kujdestari të një nxënësi të anglishtes/nxënësi shumëgjuhësh për të kontaktuar Departamentin e Shtetit të Connecticut për Edukimin me çdo pyetje ose shqetësime rreth të drejtave të këtyre nxënësve për të marrë shërbime të nxënësit shumëgjuhësh ose akomodime në dispozicion të një nxënësi të tillë ose prindërit apo kujdestarit, duke përfshirë informacione rreth çdo ankese për dështimin e bordit të edukimit për të mundësuar ose siguruar këto shërbime ose akomodime.

Kjo do të thotë se një prind ose kujdestar i një nxënësi të anglishtes ose një student që flet disa gjuhë mund të kontaktojë Departamentin e Shtetit të Connecticut për Edukimin nëse kanë ndonjë pyetje ose shqetësim rreth të drejtave të fëmijës së tyre për të marrë shërbimet ose ndihmën për mësimin e gjuhës. Kjo përfshin gjetjen se çfarë mund të bëhet nga ata nëse bordi i shkollës nuk i mundëson shërbimet ose t'i ndihmojë ata t'i ofrojnë ato shërbime.